



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika c të Ligjit për vetëqeverisje lokale, nr. 03/L-040, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, qershor 2008), nenit 27 të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, nr. 03/L-048, nenit 33, paragrafi 33.1, pika c dhe nenit 34, paragrafi 34.1, pika d të Statutit të Komunës së Prishtinës, nr. 01-110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 27.06.2023, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT 01-400/01-69255/23 TË DATËS 03.04.2023
PËR BARTJEN E MJETEVE NGA VITI 2022 NË VITIN 2023

- MIRATOHET** Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit 01-400/01-69255/23 të datës 03.04.2023 për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake, nga viti 2022 në vitin 2023, përfshirë mjetet e grumbulluara në vitet paraprake, të cilat janë të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë.
- Sipas pikës 1 të këtij Vendimi, bëhet bartja e të hyrave vetanake nga vitit 2022 në vitin 2023, në shumë prej **51,425,218.66 €**, respektivisht:
 - Bartja e mjeteve të pashpenzuara nga viti 2022 është në vlerë prej **47,264,318.01 €**,
 - Tejkalimi i planit për të hyra vetanake në vitin 2022 është në vlerë prej **4,160,900.65 €**,
- Mjetet e bartura nga viti 2022 do të destinohen në kategoritë për:

3.1. paga dhe shtesa - 110.....	100,000.00 €;
3.2. mallra dhe shërbime - 130.....	4,904,994.04 €
3.3; shërbimet e komunale -132	75,005.96 €
3.4. subvencione dhe transfere - 200	250,000.00 €;
3.5. investimet kapitale - 300	46,095,218.66 €;

Gjithsej: **51,425,218.66 €**;

- Pjesë përbërëse e këtij vendimi është pjesa tabelare.
- Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave.
- Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-400/01-134267/23, më 29.06.2023

KRYESUESI I MBLEDHJES SË KUVENDIT
AJET BRAJSHORI



Arsyetim

Bazuar në kërkesën (me email) të MF-së, Departamenti i Buxhetit, të dt. 19.6.2023, vlera prej 75,005.96 euro duhet të kalojë nga kategoria "Mallra dhe shërbime" në kategorinë ekonomike "Shpenzimet e komunaleve", edhe pse ne si OE nuk kemi obligime të papaguara në këtë kategori ekonomike, por sipas kërkesës së MF-së, duke u bazuar në:

Obligimin ligjor bazuar në nenin 9, paragrafi 6 i Ligjit mbi ndarjet buxhetore për vitin 2023, thekson si në vijim:

6. Bilancet e pashpenzuara të të hyrave vetjake të komunave nga viti fiskal 2022, të depozituara në Fondin e Kosovës dhe të regjistruara në SIMFK si ndarje buxhetore për një komunë, ndahen për vitin fiskal 2023 sipas autorizimeve të LMFPP-së, duke ruajtur strukturën e shpenzimeve dhe aprovuar me vendim të Kuvendit të Komunës.

Ndryshimi i dyte është vlera prej +0.50 euro në total të bartjes, për arsye të një gabimi në raportin e pranuar ne si Kryeqytet nga MF-ja, Departamenti i Thesarit (një pagesë e gjobës në trafik ka dallim për këtë vlerë) e që njoftimi për këtë diferencë është bërë nga Thesari pas përgatitjes dhe dorëzimit të pasqyrave financiare në MF.